



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
UNIVERSITY OF PRISHTINA**

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 3/146

Datë: 31/10/2017

Senati i Universitetit të Prishtinës në mbledhjen e datës 31.10.2017, mori

**V E N D I M**

Për plotësim-ndryshim të Rregullores së punës së sistemit elektronik për menaxhimin e studentëve (SEMS) nr. 579 të datës 2.3.2017

**Neni 1**

Neni 18 i Rregullores bazike ndryshohet si në vijim:

**Neni 18**

**Konfirmimi i pagesave të studentëve**

Konfirmimi i pagesave të studentëve, pas dorëzimit nga studentët, duhet të bëhet nga zyrtari i shërbimit të studentëve në afat jo më shumë se tri (3) ditë pune.

**Neni 2**

Neni 22 i Rregullores bazike ndryshohet si në vijim:

**Neni 22**

**Afati për vendosjen e notave**

Vendosja e notave në SEMS duhet të bëhet jo më larg se 15 ditë pune nga dita e provimit e publikuar në orarin e provimeve.

**Neni 3**

Neni 24 i Rregullores bazike ndryshohet si në vijim:

**Neni 24**

**Dorëzimi i fletëparaqitjeve fizike**

Fletëparaqitjet fizike dorëzohen, nga bartësi i lëndës, te shërbimi i studentëve, jo më larg se 22 ditë pune nga dita e provimit e publikuar në orarin e provimeve.

#### Neni 4

Neni 25 i Rregullores bazike pas pikës b i shtohet pika c, d dhe e, me tekstin si në vijim:

#### Neni 25

##### Vendosja e notës në transkript

- c. Nëse bartësi i lëndës ka vendosur gabimisht notën dhe e njëjta nuk është korrigjuar brenda afatit të paraparë si në paragrafin a) të këtij neni, bartësi i lëndës në periudhën e afatit përkatës të provimeve mund të bëjë kërkesë me shkrim te Prodekani për çështje mësimore për lejimin e korrigjimit të notës;
- d. Në rast të aprovimit të kërkesës sipas paragrafit c) të këtij neni, korrigjimi i notës mund të lejohet vetëm brenda afatit përkatës të provimeve;
- e. Dëshmia e Prodekanit për çështje mësimore për lejimin e korrigjimit të notës mbetet në dosjen e studentit.

#### Neni 5

Neni 42 i Rregullores bazike ndryshohet dhe plotësohet me dy pika të reja b dhe c, me tekstin si në vijim:

#### Neni 42

##### Hapja dhe mbyllja e afatit të provimeve

- a. Hapja e afatit për paraqitjen e provimeve bëhet 20 ditë pune para fillimit të afatit të provimeve kurse mbyllja 5 ditë pune para fillimit të afatit të provimeve
- b. Përrjashtimisht nga paragrafi a) i këtij neni, hapja e afatit për paraqitjen e provimeve në muajin Shtator bëhet ditën e 5 të punës të muajit Korrik kurse mbyllja 5 ditë pune para fillimit të afatit të provimeve
- c. Mbyllja e afatit të provimeve (mbyllja e SEMS-sit) bëhet më 25-tin e muajit pasues pas muajit respektiv të provimeve.

#### Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit në Senat.



Prof. Dr. Marjan Dema

Kryesues i Senatit, Rektor